



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Kaçanik
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILJARE

Nr. 151-1/2017

Kaçanik, 25.05 .2017

Në bazë në nenin 8 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 , Udhëzimit Administrativ Nr. 14/2011 për Rregullimin e Procedurave për Themelimin e Marrëdhënies së Punës në Sektorin Publik, Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare , bënë këtë:

SHPALLJE E REKRUTIMIT

I. QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILJARE

TITULLI I VENDIT TË PUNËS: MJEK TË MJEKËSISË FAMILJARE- 1 (një pozitë)

Vendi i punës: Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare

Koeficienti; 7.2 Gr. H-543/1

Numri i referencës së vendit të punës: 151-1/2017

Detyrat dhe përgjegjësitë

- Ofrim i shërbimeve shëndetësore në QKMF dhe në teren
- Ofron ndihmë mjekësore për të gjitha sëmundjet në përgjithësi duke u përkujdesur në vazhdimësi për mbrojtjen e shëndetit.
- Jep këshilla mjekësore rreth mbrojtjes së shëndetit dhe sëmundjeve;
- Diagnostifikimi i sëmundjes dhe trajtimi i pacientit;
- Udhëzon
- dhe trajton në mjekimin parandalues të sëmundjes.
- Kryen edhe detyra tjera të përcaktuara me legjislacionin në fuqi sa i perket mjekësisë familjare.

Procedurat e konkurimit: Procedura e konkurrimit është e hapur për të gjithë kandidatët e jashtëm si dhe ekzistues.

Kushtet e konkursit

Kandidatët të cilët konkurrojnë për këto vende pune përveç kushteve të përgjithshme të parapara me ligj, duhet ti plotësojnë edhe kushtet e veçanta;

Shkollimi i kërkuar: Fakulteti i mjekësisë së përgjithshme

Aftësitë, përvoja dhe attribute tjera që kërkohen:

- Certifikata e licencimit dhe dëshmi tjera të aftësisë,
- Të ketë shkathtësi të dëshmuara dhe efektive të komunikimit me shkrim dhe me gojë.
- Përvoja e punës e dëshirueshme

Kohëzgjatja e emërimit : Sipas ligjit të punës Nr.03/L-212.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes në mjetet e informimit publik.

Paraqitja e kërkesave: Formularët e aplikimit merren dhe dorëzohen në objektin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) **zyra nr.106**, brenda 15 ditë prej ditës së shpalljes së konkursit në shtyp.

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten këto dokumente: Kopjen e vërtetuar të Diplomës, dëshmi të përvojës së punës, certifikatën shëndetësore, kopjen e letërnjoftimit, licencën e punës, certifikatën e lindjes, dëshminë se nuk është nën hetim .

QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILJARE U SHËRBEN TË GJITHË BANORËVE TË KOSOVËS DHE MIRËPRET APLIKACIONET NGA FEMRAT DHE MESHKUJT E TË GJITHA KOMUNITETEVE TË KOSOVËS

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara mund të refuzohen. Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranura, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen. Për çdo informacion kandidatët mund të kontaktojnë në zyrën për burime njerëzore në Qendrën Kryesore të Mjekësisë familjare.



Drejtori i QKMF-së
Dr. Njazi Ilazi